



**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

RREGULLORE

**MBI LIKUIDITETIN MINIMAL TË SHOQËRIVE TË BROKERIMIT TË LETRAVE
ME VLERË**

Miratuar me vendimin e Bordit nr. 41, datë 28.05.2009

**Neni 1
Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i mënyrës së balancimit të aseteve likuide me detyrimet me afat të shkurtër të shoqërisë së brokerimit, si dhe procedurat e raportimit në Autoritet.

**Neni 2
Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përmbushja nga shoqëria e brokerimit e detyrimeve ndaj kreditorëve nëpërmjet balancimit të aseteve të saj likuide me detyrimet.

**Neni 3
Baza ligjore**

Kjo rregullore miratohet në bazë dhe për zbatim të nenit 53, të Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt” dhe nenit 14 pika 3, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”.

**Neni 4
Subjektet**

Subjekte të kësaj rregulloreje janë shoqëritë e brokerimit të licencuara në përputhje me ligjin “Për titujt” dhe Rregulloren nr. 165, datë 23.12.2008 “Për licencimin e shoqërive të brokerimit/këshillimit, brokerit dhe këshilltarit të investimeve”.

**Neni 5
Përcaktime**

Për qëllim të kësaj rregulloreje termat:

- 1.“likuiditet” do të nënkuptojë “kapital likuid neto”;
- 2.“asetet likuide” do të nënkuptojë “fondet e veta likuide”;
- 3.“treguesi i likuiditetit” do të nënkuptojë “treguesi i fondeve likuide neto”;

4. "balancim" do të nënkuptojë "ekuilibrim", (përdorur në Ligjin nr. 9879, datë 21.02.2008 "Për Titujt").

Ndërsa termat e mëposhtëm do të kenë këto kuptime:

1. "periudhë raportuese" është muaji kalendarik;
2. "detyrim me afat të shkurtër" është detyrimi me afat maturimi brenda një viti nga data e llogaritjes së treguesit të likuiditetit;
3. "tregues i likuiditetit" është raporti mes totalit të aseteve likuide me totalin e detyrimeve me afat të shkurtër.

Neni 6 Treguesi i likuiditetit

Vlera më e ulët, e detyrueshme, e treguesit të likuiditetit të një shoqërie brokerimi duhet të jetë 1.00 (një).

Neni 7 Asetet likuide

Totali i aseteve likuide në kuptim të kësaj rregulloreje përfshin:

1. Mjetet në të holla në bankë dhe në arkë,
2. Depozitat me afat 90 ditë dhe afat me të shkurtër se 90 ditë,
3. Bonot e thesarit të emtuara nga Qeveria Shqiptare dhe letrat me vlerë të emtuara nga Banka e Shqipërisë,
4. Vlera likuide neto e llogarive të arkëtueshme, vlera totale e të cilave llogaritet duke zbritur nga vlera totale e llogarive të arkëtueshme me afat të shkurtër, llogaritë e mëposhtme:
 - llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura
 - llogaritë e arkëtueshme që nuk lidhen me transaksionet në letrat me vlerë
 - llogaritë e arkëtueshme nga interesat
 - llogaritë e tjera të arkëtueshme me maturim më të lartë se 30 ditë, ose që u ka kaluar afati i maturimit 5 ditë
5. Letrat me vlerë të portofolit të vetë shoqërisë, ku përfshihen:
 - aksionet,
 - obligacionet,
 - kuotat e fondeve të investimit,
 - letra të tjera me vlerë.

Neni 8 Vlerësimi letrave me vlerë

1. Letrat me vlerë duhet të vlerësohen nga shoqëria e brokerimit sipas çmimit të mbylljes me mbylljen e tregut.
2. Në rastet kur letrat me vlerë nuk tregtohen rregullisht çdo ditë tregtimi, ato vlerësohen duke u mbështetur në çmimin e mbylljes të shtatë ditëve të fundit të tregtimit.
3. Në rastet kur paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni nuk janë të zbatueshme, letrat me vlerë duhet të vlerësohen sipas çmimit mesatar të mbylljes.

4. Çmimi mesatar i mbylljes, është mesatarja e ponderuar e çmimeve të mbylljes për 30 ditët e fundit.
5. Në rast kur letrat me vlerë nuk janë tregtuar në 30 ditët e fundit, ato nuk përfshihen në asetet likuide.
6. Bonot e thesarit të emetuara nga Qeveria Shqiptare apo letrat me vlerë të Bankës së Shqipërisë vlerësohen me vlerën e tyre nominale.
7. Kuotat e fondeve të investimit vlerësohen sipas çmimit të fundit të përcaktuar për këto kuota.

Neni 9

Llogaritja e treguesit të likuiditetit

1. Shoqëria e brokerimit duhet të llogarisë treguesin e likuiditetit mbi bazë ditore. Llogaritjet ditore bëhen në përputhje me të dhënat e formularit sipas përcaktimit të nenit 10, të kësaj rregulloreje.
2. Në rastin kur vlera e treguesit të llogaritur është më i vogël se 1 (një), shoqëria e brokerimit njofton menjëherë Autoritetin sipas formatit të përcaktuar në nenin 10, të kësaj rregulloreje.
3. Në rastin kur vlera e treguesit të llogaritur është më e vogël se 1 (një), sipas paragrafit 2 të këtij neni, shoqëria e brokerimit duhet të përshtatë veprimtaritë e saj me dispozitat e kësaj rregulloreje brenda 3 (tre) ditëve.

Neni 10

Dërgimi i raporteve

1. Shoqëria e brokerimit dërgon raportet për llogaritjet ditore të treguesit të likuiditetit në mënyrë elektronike në Autoritet, mbi bazë mujore, duke plotësuar formularin.
2. Formulari për llogaritjen e treguesit të likuiditetit dhe instruksionet për plotësimin e tij janë pjesë integrale e kësaj rregulloreje.
3. Afati i dërgimit të raportit, duhet të jetë brenda 5 ditë pune nga dita e fundit e periudhës raportuese.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit të saj në faqen elektronike zyrtare të AMF-së.

Elisabeta GJONI
KRYETAR

Formular

Për llogaritjen e treguesit të likuiditetit – mbi bazë ditore

Shoqëria e brokerimit: _____

Periudha raportuese : _____

Nr	Përshkrimi	Data 1	Data 2	Data 30
1	Mjetet në të holla në bankë dhe në arkë				
2	Depozitat me afat 90 ditë dhe afat me të shkurtër se 90 ditë				
3	Bonot e thesarit të emetuara nga Qeveria shqiptare dhe letrat me vlerë të emetuara nga Banka e Shqipërisë				
4	Vlera totale e llogarive të arkëtueshme				
4.a	Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura				
4.b	Llogaritë e arkëtueshme që nuk lidhen me transaksionet në letrat me vlerë				
4.c	Llogaritë e arkëtueshme nga interesat				
4.d	Llogaritë e tjera të arkëtueshme me amortim më të lartë se 30 ditë ose që u ka kaluar afati i maturimit 5 ditë				
4e	Vlera totale neto e llogarive të arkëtueshme likuide (4 -4 -4b -4c - 4d)				
5	Letrat me vlerë të portofolit të vetë shoqërisë (5a+5b+5c+5d)				
5.a	aksionet				
5.b	obligacionet				
5.c	kuotat e fondeve të investimit				
5.d	letra të tjera me vlerë				
6	Vlera totale e asetëve likuide (1+2+3+4e+5)				
7	Totali i detyrimeve				
7a	Detyrimet me afat mbi një vit				
7b	Detyrimet me afat të shkurtër (7-7a)				
8.	Treguesi i likuiditetit (6/7b)				
9	Gjendja mbi llogarite e klientëve				

Personi i autorizuar nga shoqëria

Instruksiione për plotësimin e formularit

Të dhënat për “**mjetet në të holla në bankë dhe në arkë**” plotësohen duke marrë shumën e parave në cash (në lekë dhe valutë të huaj) që janë në arkën e shoqërisë dhe në llogaritë rrjedhëse të shoqërisë në bankat përkatëse. Nuk përfshihen këtu llogaritë e klientëve.

Të dhënat për “depozitat me afat 90 ditë dhe afat më të shkurtër se 90 ditë” plotësohen duke marrë shumën e parave që shoqëria mban si depozita me afat pranë bankave.

Të dhënat për “bonot e thesarit të emetuara nga Qeveria shqiptare dhe letrat me vlerë të emetuara nga Banka e Shqipërisë” plotësohen duke marrë vlerën nominale të tyre.

Të dhënat për “Totalin e Llogarive të arkëtueshme” plotësohen duke marrë vlerën e gjithë llogarive të arkëtueshme.

Në lidhje me zërat që do të zbriten nga totali i llogarive të arkëtueshme duhet të kihet kujdes që ato do të zbriten vetëm njëherë, pasi në disa raste mund të duket sikur u përket dy zërave (për shembull, interesi për t’u marrë nga anëtarët e Bordit, mund të përfshihet edhe tek zëri llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura dhe në të njëjtën kohë edhe tek zëri llogari të arkëtueshme nga interesat)

Të dhënat për “Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura” plotësohen duke marrë të gjitha llogaritë e arkëtueshme nga punonjësit, anëtarët e bordit menaxhues, këshillit mbikëqyrës, me të drejtë vote më shumë se 5%, ose nga anëtarët e familjeve të tyre, si dhe degët që zotërohen plotësisht apo pjesërisht.

Të dhënat për Llogaritë e arkëtueshme që nuk lidhen me transaksionet në letrat me vlerë plotësohen duke marrë vlerën e të llogarive të arkëtueshme me afat të shkurtër që nuk lidhen me transaksionet me letrat me vlerë.

Të dhënat për Llogaritë e arkëtueshme nga interesat plotësohen duke marrë vlerën e të llogarive të arkëtueshme nga interesat.

Të dhënat për Llogaritë e tjera të arkëtueshme me maturim më të lartë se 30 ditë ose që u ka kaluar afati i maturimit 5 ditë, plotësohen duke marrë vlerën e të llogarive të arkëtueshme me maturim më të lartë se 30 ditë, pavarësisht nga periudha e maturimit dhe atyre që u ka kaluar afati i maturimit 5 ditë apo me shumë.

Të dhënat për Vlerën totale neto e llogarive të arkëtueshme likuide plotësohen duke marrë diferencën mes vlerës totale të llogarive të arkëtueshme me afat shkurt dhe vlerës të pikës 4a, 4b, 4c dhe 4d.

Të dhënat për “letrat me vlerë të portofolit të vetë shoqërisë” plotësohen duke marrë vlerën totale të letrave me vlerë që mban shoqëria në porofolin e vet.

Aksionet vlerësohen me çmimin e tregut,

Obligacionet me vlerën nominale

Kuotat e fondeve me çmimin më të fundit të tyre.

Të dhënat për “Detyrimet totale” plotësohen duke përfshirë vlerën totale të detyrimeve të shoqërisë.

Të dhënat për “Detyrimet me afat maturimi mbi një vit” plotësohen duke përfshirë vlerën totale të detyrimeve të shoqërisë, maturimi i të cilave është më i gjatë se një vit nga dita më e fundit e periudhës raportuese.

Të dhënat për “Totalin e detyrimeve me afat të shkurtër” plotësohen duke përfshirë diferencën mes vlerës së totalit të detyrimeve dhe vlerës së detyrimeve me afat maturimi mbi një vit.

Të dhënat mbi “Gjendjen e llogarive të klientëve” plotësohen duke u mbështetur në gjendjen ditore të fondeve në cash të llogarive të klientëve.

Formulari i plotësuar depozitohet në AMF çdo muaj, duke treguar në secilën kolonë të dhënat për çdo ditë tregtimi.